

Vere ne Detin Balltik, 31Korrik,14Dite, 669 € (O-ETR-755)**Shteti:** Suedi**Kategoria Ofertes:** Vere ne Detin Balltik, 28Gusht, 14 Dite, 669 €**Emri Hotelit:** Standart hotel - 3 Yje**Tipi Ofertës:** Mëngjes**Kohezgjatja:****Nisja:****Transporti:** Autobus**Cmimi:****Suedi**

Dita e Parë: Nisja në orën 04:00 nga Tirana me autobus nëpërmjet pikës kufitare Muriqan, për në Zadar. Udhëtimi zgjat rreth 12 orë pa ndalesa. Ndajesa të shkurtra për kafe dhe ushqim gjatë udhëtimit. Mbrirja në Zadar. Vizitë panoramike në Zadar: Kisha Shën Donat, Forumi Roman, Katedralja Anastasia e Zadarit dhe Universiteti I Zadarit. Sistemimi dhe Fjetje në Hotel.

Dita e Dytë: Mëngjesi në Hotel. Nisja për në Ljubjanë. Udhëtimi zgjat rreth 4 orë pa ndalesa. Vizitë panoramike në Ljubjanë: Kisha Treshe, Qyteti Vjetër, Ura Dragon, Kështjella Ljubljanës, Sheshi Republikës. Vazhdon udhëtimi për në Salzburg. Udhëtimi zgjat rreth 3 orë pa ndalesa. Vizitë panoramike në Salzburg: Rruga Getreidegasse, Sheshi Alter Markt, Katedralja Dom zu Salzburg, Kështjella Hohensalzburg, Schloss Mirabell dhe Hellbrunn. Pasdite vonë, vazhdon udhëtimi për në Mynih. Udhëtimi zgjat rreth 2 orë pa ndalesa. Mbrirja në Mynih. Sistemimi dhe Fjetje në Hotel.

Dita e Tretë: Mëngjesi në Hotel. Vizitë panoramike në Mynih: Muzeu i Arteve të Pinakotheken, Hofbrauhaus-i i famshëm, Teatri Kombëtar, Pallati Mbretëror, Marienplatz, Viktualien Market. Pallati Nymphenburg, Sheshet Olimpikë, ku gjenden Muzeumi i BMW, Kulla Olimpikë 290 metra e lartë etj. Rreth orës 12.00, Nisja për në Hannover. Udhëtimi zgjat rreth 8 orë pa ndalesa. Ndajesa të shkurtra gjatë udhëtimit për kafe. Mbrirje në Hannover. Sistemimi dhe Fjetje në Hotel.

Dita e Katërt: Mëngjesi në Hotel. Vizitë panoramike në Hannover: Kisha e Tregut, Bashkia e Qytetit të vjetër, Kisha Kreuz, Fontana Oskar Winter, Kisha Aegidien, Shtëpia Leibnitz, Bashkia e re e Qytetit. Rreth orës 12.00, Nisja për në Hamburg. Udhëtimi zgjat rreth 1 orë e 30 minuta. Vizitë panoramike në Hamburg: Monckebergstrasse, Bashkia Qytetit, Kisha Shën Nikolai, Speicherstadt, Elbphilharmonie dhe Porti Hamburgut. Nisja për në Kopenhagen. Udhëtimi zgjat rreth 5 orë pa ndalesa. Mbrirja në Kopenhagen. Sistemimi dhe Fjetje në Hotel.

Dita e Pestë: Mëngjesi në Hotel. Vizitë panoramike në Kopenhagen: Katedralja e Kopenhagenit, Universiteti i Kopenhagenit, Rundetaarn, Sheshi Radhusplatsen, Bashkia e Kopenhagenit, Pallati Kristianborg, Pallati Rosenberg, Sheshin qëndror Amalienborg, Pallati aktual i Monarkisë Daneze, Kisha e Frederikut, Shatërvani Gefyon, Sirena e vogël e Hans Peter Andersen, Nyhavn dhe fabrika e Calsberg. Rreth orës 12.00, Nisja për Helsingör, udhëtimi zgjat rreth 1 orë. Vizitë panoramike në Helsingör: Kështjella Kronborg në Helsingör, në të cilën zhvillohen ngjarjet e Hamletit. Vazhdon udhëtimi me traget në Helsingborg. Vizitë panoramike në Helsingborg: Bashkia e qytetit, sheshi qëndror Stortorget, Kështjella Kärnan. Më pas Nisja për në Göteborg, udhëtimi zgjat rreth 2 orë. Mbrirja në Göteborg. Vizitë panoramike në Göteborg: Sheshi i Gustav Adolf, Bashkia e qytetit, Qyteti i vjetër Stortorget dhe Domkyrkan, Kopshti mbretëror Kungsparken, Lagja e vjetër e ndërtuar nga Hollandezet, "Haga". Në fund vizitohet sheshi Götaplatsen, ku gjenden disa prej institucioneve kryesore kulturore të Gotenborgut. Sistemimi dhe Fjetje në Hotel.

Dita e Gjashtë: Mëngjesi në Hotel. Nisja për në Oslo. Udhëtimi zgjat rreth 3 orë pa ndalesa. Ndajesa të shkurtra gjatë udhëtimit për kafe. Mbrirje në Oslo. Vizitë panoramike në Oslo: Kështjella Akershus, Kështjella mesjetare qytetit, Bashkia e qytetit "Rathuset", ku çdo vit jepet çmimi i Nobel për paqe, Bulevardi qëndror Karl Johan Gate, Teatri Kombëtar, Parlamenti i Norvegjisë, Pallati mbretëror i Monarkut Norvegjez, Parku me skulptura të Gustav Vigeland, Parku i jashtëzakonshëm "Frogner", Pista e skive Holmenkollen. Sistemimi dhe Fjetje në Hotel.

Dita e Shtatë: Mëngjesi në hotel. Nisja për në Stockholm. Udhëtimi zgjat rreth 6 orë pa ndalesa. Ndajesa të shkurtra gjatë

Udhëtimit për kafe dhe ushqim. Mbrirje në Stockholm. Sistemimi dhe Fjetje në Hotel.

Dita e Tetë: Mëngjesi në hotel. Vizitë panoramike në Stockholm: Pallati Drottingholmen, Bashkia e qytetit ku çdo vit mbahet ceremonia e nderimit të laureantëve të çmimeve Nobel nga Mbretëria Suedeze, qyteti i vjetër si dhe ishulli qendror Gamla Stan, Pallati i vjetër Mbretëror, Sheshi qendror i qytetit Stortorget, ku gjendet Akademia Suedeze si dhe Muzeu i Nobelit. Fjetje në hotel.

Dita e Nëntë. Nisja heret në Mëngjes për në Stacionin e Trageteve. Nisja me traget për në Turku në orën 07.00. Mbrirja në Turku në orën 19.00. Vazhdimi udhëtimit me autobus për në Helsinki. Udhëtimi zgjat rreth 1 orë e 30 minuta. Sistemimi dhe Fjetje në Hotel.

Dita e Dhjetë: Mëngjesi në Hotel. Vizitë panoramike në Helsinki: Katedralja Uspenski, Sheshi Senatit, Kisha Lutheran, Bashkia Qytetit, Pallati Kongreseve Finlandia Hall, Ndërtesa e Parlamentit, Parliament House, Rruga Mannerheim, Ndërtesa Opera House, Stadiumi Olimpik, Kisha Rock, Parku Sibelius dhe Stacioni Qendror i Trenit. Rreth orës 14.00, Nisja për në Tallin me Traget. Udhëtimi zgjat rreth 2 orë. Mbrirje në Tallin. Sistemimi dhe Fjetje në Hotel.

Dita e Njëmbëdhjetë: Mëngjesi në Hotel. Vizitë panoramike në Tallin: Zona e Festivalit Laulupidu, Muzeu i hapur Viimsi vabaõhumuseum, Kulla Televizive e Tallinit, Pallati Mbretëror Kadriorg, Katedralja e Aleksander Nevskit, Rruga Kohtu, Rruga Pikk Jalg, Qendra e qytetit të vjetër, Bashkia e qytetit, Sheshi Raekoja si dhe Rruga Viru. Rreth orës 12.00, Nisja për në Riga. Udhëtimi zgjat rreth 4 orë. Ndajesa të shkurtra gjatë rrugës. Mbrirja në Riga. Vizitë panoramike: Brigjet e Lumit Daugava, Kështjella e Rigës, Sheshi Doma Laukums, Bulevardi Smilšu Iela, Muzeu Latvijas Kara Muzejs, Parku i kodrave të Bastioneve, Monumenti i Lirisë, Ora Laima, Teatri i Operas dhe Baletit, Bulevardi Audeju Iela dhe Kishën mesjetare e Shën Pjetrit. Sistemimi dhe Fjetja në Hotel.

Dita e Dymbëdhjetë: Mëngjesi në Hotel. Nisja për në Vilnius. Udhëtimi zgjat rreth 4 orë pa ndajesa. Mbrirja në Vilnius. Vizitë panoramike në Vilnius: Lumi Neris, Muzeu Kombëtar i Lituaniës, Kulla Gediminas, Sheshi i Katedrales. Katedralja e Vilniusit, Pallati Presidencial, Universiteti i Vilniusit, Kisha e Shën Anës, Bulevardi Didžioji Gatve, Sheshi qendror i Vilniusit, Bashkia e kryeqytetit, Bulevardi Austros Vartai, Orkestra Filarmonike e Vilniusit, Kisha Ortodokse e Shpirtit të Shenjtë. Vazhdon udhëtimi për në Varshavë. Udhëtimi zgjat rreth 5 orë pa ndajesa. Ndajesa të shkurtra gjatë udhëtimit. Mbrirja në Varshavë. Sistemimi dhe Fjetja në Hotel.

Dita e Trembëdhjetë: Mëngjesi në Hotel. Vizitë panoramike në Varshavë: Sheshi kryesor Rynek Starego Miasta, Monumenti i Mbretit Sigismund III, Pallati Mbretëror Polak, Bulevardi Krakowskie, Pallati Presidencial, Galeria Kordegarda, Sheshi Jozef Pilsudski, Statuja e Ushtarit të Panjohur, Universiteti i Varshavës, Statuja e Astronomit Nikola Kopernikus dhe në fund, Pallati i Kulturës dhe Shkencës. Rreth orës 12.00, Nisja për në Krakow. Udhëtimi zgjat rreth 3 orë. Ndajesa të shkurtra gjatë rrugës. Mbrirja në Krakow. Vizitë panoramike në Krakow: Sheshi Mariacki, Bazilika e Shen Marias, Sheshi Qendror i qytetit të vjetër Rynek Główny, Monumenti i Adam Mickiewicz, Godina rilindase Sukiennice, ku gjendet Muzeu i Artit Polak, Muzeu Historik i Krakovit, Kodra Wawel ku gjendet Kështjella mbretërore Wawel. Vazhdon udhëtimi për në Budapest, që zgjat rreth 4 orë pa ndajesa. Mbrirja në Budapest. Sistemimi dhe Fjetja në Hotel.

Dita e Katërbëdhjetë: Mëngjesi në Hotel. Vizitë panoramike në Budapest: Kodra Gellert, Fortesa e Peshkatarit, Kisha e Shën Matias, Katedralja e Shën Stefanit, Kështjella Vayda Hunjad, Sheshi i Heronjve, Citadela. Rreth orës 11.00, Nisja për në Tiranë. Udhëtimi zgjat rreth 14 orë pa ndajesa. Ndajesa të shkurtra gjatë udhëtimit për ushqim dhe kafe. Mbrirja në Tiranë, vonë pas mesnate.

Nisja më 31 Korrik

Me Shume Detaje:

Çmimi për person të rritur në dhomë dyshe 669Eur.

Në pagesë përfshihen:

1. Udhëtimi me autobus: Tiranë - Zadar - Mynih - Hannover - Kopenhagen - Goteborg - Oslo - Stockholm - Helsinki - Tallinn - Riga - Varshavë - Budapest - Tiranë.
2. Udhëtimi me traget Stockholm - Turku dhe Helsinki - Tallin.



3. Akomodim në hotel: Fjetje: 1 natë në Zadar, 1 natë në Mynih, 1 natë në Hannover, 1 natë në Kopenhagen, 1 natë në Goteborg, 1 natë në Oslo, 2 netë në Stockholm, 1 natë në Helsinki, 1 natë në Tallinn, 1 natë në Riga, 1 natë në Varshavë, 1 natë në Budapest.

4. Mëngjeset në Hotele sipas programit.

5. Shëtitjet me autobus sipas programit.

6. Shoqërues shqiptar gjatë qëndrimit jashtë Shqipërisë.

Në pagesë nuk janë përfshirë:

1. Gjithshka që nuk është përmendur në këtë program.

2. Hyrjet në monumente dhe muzeume.

eTour.al